AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Maj 2024

07.06.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin maj 2024, viti bazë 2015=100.

Çmimet e konsumit shkuan në 2,4% vjetore dhe -0,4% mujore

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 2,4% në muajin maj 2024, krahasuar me muajin maj 2023. Inflacioni mujor ishte -0,4% në muajin maj 2024.

Maj 2024 / Prill 2024 -0,4 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit pësoi rënie në një mesatare prej -0,4% në muajin Maj 2024 krahasuar me muajin Prill 2024. Kjo kryesisht është shpjeguar me rënien e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: perimet (-9,1%) dhe karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-3,2%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,6 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa ngritje e çmimeve vërehet te nëngrupet e COICOP-it: energjia elektrike (3,6%) dhe pemët (3,1%)
me një ndikim prej 0,2 për qind në IHÇK-it.

Maj 2024 / Maj 2023 2,4 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 2,4 % në muajin Maj 2024 krahasuar me muajin Maj 2023. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: pushime të organizuara (12,9%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (9,9%), pijet alkoolike (7,4%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (6,8%), kafja, çaji dhe kakao (6,7%), shërbimet për transport (6,6%), sheqeri, reçeli, mjalta, çokollata dhe ëmbëlsirat (6,0%), pemët (6,0%), qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (5,6%), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (5,3%), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (5,0%), veshje (4,4%), kujdesi personal (4,3%), gjërat dhe pajisjet tjera rekreative, kopshtet dhe manaret (3,6%), mirëmbajtja dhe rregullimi i vendbanimit (3,4%), duhani (2,9%), shërbimet hoteliere (2,4%), buka dhe drithërat (2,3%) dhe mishi (1,2%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2,6 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: perimet (-2,8%) dhe qumështi, djathi dhe vezët (-1,6%) me një ndikim prej -0,2 për qind në IHÇK-it.

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Norma mujore dhe vjetore e inflacionit në % të matura nga IHÇK



Ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në % për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2024 në ‰	V - 2024 2015=100	V- 2024 IV- 2024	V - 2024 V - 2023
00	Gjithsej IHÇK	1000,0	129,6	-0,4	2,4
01	Ushqimi dhe pijet joalkoolike	351,1	144,1	-0,8	1,5
02	Pijet alkoolike, duhani	67,6	140,2	0,4	4,3
03	Veshje dhe këpucë	40,6	108,7	0,2	3,1
04	Strehimi , uji, energji elektrike, gazi dhe lëndë djegëse të tjera	89,8	122,4	0,7	3,3
05	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	63,0	122,3	0,2	3,0
06	Shëndetësia	22,8	116,2	0,0	2,0
07	Transporti	176,7	121,1	-1,1	3,0
08	Mjetet e komunikimit	23,7	114,4	-0,1	-0,3
09	Rekracioni dhe kultura	44,5	106,3	-0,1	3,6
10	Arsimi	6,9	104,0	0,0	-0,9
11	Restorantet dhe hotelet	40,8	130,1	0,4	2,4
12	Mallrat dhe shërbimet e ndryshme	72,2	119,4	0,1	2,3

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin maj 2024, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation